



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresë
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 252/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresë (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendlorur përkufizimi me ankesën e Komunës së Graçanicës, paraqitur kundër subjekteve të ndryshme politike, për shkak të vendosjes posterave në shenjat publike të trafikut, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2013, mori këtë:

VENDIM

Hidhet si e parregullt ankesa e Komunës së Graçanicës,

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datën 11.10.2013, nga komuna e Graçanicës në të cilën thekson se në rrugët kryesore të Komunës se Graçanicës dhe ne rrugët qe lidhen me fshatrat e kësaj komune subjektit të ndryshme politike kane vendlorur posterat dhe njoftimet e subjekteve te tyre politike ne shenjat e trafikut publik ku me çrafit i kane sjelle ne një gjendje te keqe keto shenja. Me kete rast parashtruesi i ankeses thekson se perveç demit material eshte rrezikuar edhe siguria e të gjithe pjesmarresve te trafikut. Me kete rast parashtruesi i ankeses kërkon që ndaj shkelesve qe të ndermiren masat ndeshkimore

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

Ankesa është e parregullt

PZAP-i konstaton se ankesa e Komunës së Graçanicës është e parregullt pasi që parashtruesi i ankesës nuk ka cekur në ankesën e saj kryesit e supozuar të shkeljes por vetëm se tregon se në rrugët e Komunës së Graçanicës janë të vendosura posterat të subjekteve të ndryshme politike pa u precizuar se të kujt janë ato postera dhe se kush i ka vendlorur ato, andaj PZAP-i më mbështetje të nenit 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it si dhe më mbështetje të nenit 118.1 të LZP-së vendosi si më diapositiv të këtij vendimi

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresë

Anr. 252/2013 më datën 25.10.2013.

Kryesuesi i Panelit
Nehat Idrizi

PZAP

Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.